

L I G J
Nr. 8967, datë 7.11.2002

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË BASHKËPRODHIMIT KINEMATOGRAFIK
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS ITALIANE”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:**

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e bashkëprodhimit kinematografik ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Italiane”, bërë në Tiranë më 10.5.2002.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr. 3584, datë 4.12.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJE

**BASHKËPUNIMI KINEMATOGRAFIK MIDIS QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE**

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Italiane, të quajtura në vazhdim “palët”,

Të vetëdijshëm për kontributin që bashkëprodhimet mund t'i sjellin zhvillimit të industrisë kinematografike si dhe rritjes së shkëmbimeve ekonomike dhe kulturore mes Shqipërisë dhe Italisë,

Të vendosur për të nxitur zhvillimin e bashkëpunimit kinematografik mes dy vendeve,

Ranë dakord për sa vijon:

Neni 1

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, termi film nënkupton veprat kinematografike me çfarëdo kohëzgjatje dhe të çfarëdolloji suporti teknik, duke përfshirë këtu ato fiction, vizatimorë apo dokumentarë, në përputhje me dispozitat mbi industrinë kinematografike që ekzistojnë në secilin nga dy vendet, shpërndarja e parë e të cilave do të bëhet në sallat kinematografike të të dy Vendeve.

Neni 2

Filmat e realizuar me bashkëprodhim, të mbrojtur nga kjo Marrëveshje, do të gëzojnë me të drejta të plota avantazhet për filmat kombëtare, të parashikuara nga dispozitat përkatëse për industrinë kinematografike, që janë në fuqi apo që mund të shpallen në secilin nga të dy Vendet.

Gjithsesi, Autoritetet kompetente mund të kufizojnë ndihmat e përcaktuara sipas dispozitave që janë apo mund të hyjnë në fuqi në Vending që i jep këto ndihma, në rastin e bashkëprodhimeve financiare ose në raste kur kontributi financiar nuk është në përpjestim me pjesëmarrjet teknike dhe artistike. Kufizimi në fjalë duhet t'i komunikohet bashkëprodhuesit të interesuar në momentin e

miratimit të projektit të bashkëprodhimit.

Këto avantazhe do t'i lejohen vetëm prodhuesit të Vendi që i jep ato.

Neni 3

Realizimi i filmave me bashkëprodhim midis dy Vendeve duhet të miratohet, pas një konsultimi reciprok, nga autoritetet kompetente:

- Në Shqipëri: Qendra Kombëtare e Kinematografisë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve;
- në Itali: Drejtoria e Përgjithshme e Kinemasë në Ministrinë e Pasurive dhe Veprimtarive Kulturore.

Neni 4

Për të gëzuar të drejtën e përfitimeve që vijnë nga bashkëprodhimi, filmat duhet të realizohen nga prodhues që disponojnë një organizim të mirë si nga ana teknike ashtu dhe nga ajo financiare, si dhe një përvojë dhe kualifikim profesional, të njohur nga autoritetet kompetente të përmendura në nenin 3.

Neni 5

Kërkesat për pjesëmarrje në përfitimet e bashkëprodhimit, të paraqitura nga prodhuesit e secilit prej dy Vendeve, duhet të miratohen sipas normave të procedurës, të parashikuara në Aneksin e kësaj Marrëveshjeje, i cili është pjesë përbërëse e saj.

Ky miratim është i pakthyeshëm me përjashtim të rastit kur ka ndryshime thelbësore në parashikimet paraprake në fushën artistike, ekonomike dhe teknike.

Neni 6

Përpjestimi i kontributeve përkatëse të bashkëprodhuesve të të dyja Vendeve mund të luhatet nga njëzetë deri në tetëdhjetë për qind për film (20-80%).

Kontributi i bashkëprodhuesit minoritar duhet të përfshijë detyrimisht një pjesëmarrje teknike, artistike dhe krijuese konkrete, në parim, në përputhje me masën e investimit të tij. Në raste të veçanta mund të bëhen përjashtime dhe këto përcaktohen nga autoritetet kompetente të të dy Vendeve.

Konsiderohen personel krijues, teknik dhe artistik, personat që janë cilësuar si të tillë në legjislacionin të secilit prej dy Vendeve. Kontributi i secilit prej subjekteve të mësipërm do të vlerësohet individualisht.

Në vija të përgjithshme, kontributi i secilit Vend do të përfshijë të paktën një element krijues (autor i subjektit, skenarist, regjisor, autor i muzikës, montues, drejtor fotografie, skenograf, fonist), një aktor në rol kryesor, një aktor në rol dytësor dhe një teknik të kualifikuar.

Për këto qëllime aktori në një rol kryesor mund të zëvendësohet të paktën nga dy teknikë të kualifikuar.

Neni 7

Filmat duhet të realizohen nga regjisorë shqiptarë, ose italianë (ose të një Vendi të Bashkimit Europian), me pjesëmarrjen e teknikëve apo interpretuesve me kombësi shqiptare, ose italiane (ose prej njërit nga Vendet e Bashkimit Europian).

Mund të pranohet pjesëmarrja e interpretuesve dhe e teknikëve të ndryshëm nga ata që përmenden në paragrafin paraardhës, duke marrë në konsideratë kërkesat për filmin dhe pas një marrëveshjeje midis autoriteteve kompetente të të dy Vendeve.

Filmimet duhet të kryhen në territorin e Vendeve bashkëprodhuese; mund të bëhen përjashtime për arsye artistike nga ana autoriteteve kompetente.

Neni 8

Në rast bashkëprodhimi shumëpalësh, pjesëmarrja më e ulët nuk mund të jetë më pak se 10% (dhjetë për qind), dhe më e larta nuk mund të kalojë 70% (shtatëdhjetë për qind) të kostos totale. Kushtet për pranimin e veprave kinematografike duhet të shqyrtohen rast pas rasti.

Neni 9

Duhet të ruhet ekuilibri i duhur si përsa i përket pjesëmarrjes së personelit krijues, artistik e teknik ashtu edhe mjeteve financiare dhe teknike të të dy Vendeve (studiot e xhirimeve dhe laboratorët). Me qëllim ruajtjen e ekuilibrit financiar dhe numrit të filmave, mund të merren në konsideratë filmat kombëtar shqiptarë dhe italianë të shpërndarë dhe/ose një parapagesë nga ana e një kanali televiziv.

Komisioni i përbashkët, i parashikuar nga neni 18-të i kësaj Marrëveshjeje do të shqyrtojë respektimin e këtij ekuilibri dhe, në rast të kundërt, do të marrë masat e gjykuara të nevojshme për ta rivendosur atë.

Neni 10

Punimet e filmimeve në studiot e xhirimeve, e regjistrimit të zërit dhe të laboratorit duhet të realizohen duke respektuar dispozitat e mëposhtme:

a) filmimet në studiot e xhirimeve preferohen të bëhen në territorin e dy Vendeve bashkëprodhues;

b) secili prodhues është, në çdo rast, bashkëpronar i negativit origjinal (figurë dhe zë), cilido qoftë vendi ku depozitohet;

c) në çdo rast, çdo bashkëprodhues ka të drejtën e një negativi të versionit të tij. Nëse një prej bashkëprodhuesit heq dorë nga kjo e drejtë, negativi do të depozitohet në një vend të zgjedhur nga bashkëprodhuesit me marrëveshje të përbashkët.

d) në parim, puna pas filmimit dhe zhvillimit i negativit do të bëhet në studiot dhe laboratorët e Vendi mazhoritar ashtu si dhe shtypja e kopjeve të destinuara për t'u projektuar në të njëjtin Vend; kopjet që do të përdoren në Vendin minoritar do të kryen në një laborator të këtij Vendi;

e) Pagesa e fundit e mundëshme e kuotës minoritare duhet t'i jepet bashkëprodhuesit mazhoritar brenda gjashtëdhjetë ditësh, duke filluar nga data e dorëzimit e të gjithë materialit të nevojshëm për përgatitjen e versionit të filmit në Vendin e bashkëprodhuesit minoritar.

Neni 11

Duke respektuar legjislacionin dhe rregulloren e dy Vendeve, secila nga Palët kontraktuese do të lehtësojë hyrjen dhe qëndrimin në territorin e saj të personelit teknik dhe artistik të Palës tjetër. Në të njëjtën mënyrë, do të autorizojë importimin e përkohshëm dhe rieksporimin e materialit të nevojshëm për prodhimin e filmave të realizuar brenda kësaj Marrëveshjeje dhe do të lehtësojë hyrjen dhe qëndrimin në territorin e saj të personelit të punës.

Neni 12

Klauzolat kontraktuale që parashikojnë ndarjen e çdo lloji fitimi dhe të territoreve midis bashkëprodhuesve, do të varen nga miratimi i autoriteteve kompetente të dy Vendeve. Kjo ndarje duhet të jetë në përpjestim me mbështetjen financiare përkatëse të bashkëprodhuesve.

Neni 13

Në rast se një film i realizuar me bashkëprodhim eksportohet në një Vend ku është caktuar një kontigjent për importimet e veprave kinematografike:

a) sipas rregullit, filmi i shtohet kontigjentit të Vendi që ka pjesëmarrjen mazhoritare;

b) në rastin e filmave për të cilët të dyja Vendet kanë të njëjtën pjesëmarrje, vepra do t'i

shtohet kontigjentit të Vendit që ka kushtet më të mira për eksportim;

c) në rast vështirësish, filmi do t'i caktohet kontigjentit të Vendit të origjinës së prodhuesit;

d) nëse një nga Vendet bashkëprodhues ka mundësi importimi të lirë të filmave të tij në Vendin importues, filmat e prodhuar nga të dyja palët, ashtu si ata kombëtarë, do të gëzojnë plotësisht të drejtën e një mundësie të tillë.

Neni 14

Filmat e realizuar me bashkëprodhim duhet të paraqiten me diçiturën: "Bashkëprodhim shqiptaro-italian" ose "Bashkëprodhim italo-shqiptar". Një diçiturë e tillë duhet të figurojë në tituj, në krye apo në fund, në të gjithë propagandën dhe reklamën tregtare, në materialin e promovuar dhe në çdo vend ku prezantohet bashkëprodhimi i sipërpërmendur.

Neni 15

Veprat kinematografike të realizuara me bashkëprodhim dhe që prezantohen në Festivalet Ndërkombëtare, duhet të përmendin të gjithë Vendet bashkëprodhuese.

Neni 16

Duke bërë përjashtim nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, mund të përfitojnë çdo vit nga bashkëprodhimi dypalësh, filma të realizuar në secilin nga dy Vendet, të cilët duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) të kenë një cilësi teknike dhe një vlerë artistike të veçantë, të denjë për të prezantuar një interes të padiskutueshëm për kinemanë europiane; këto karakteristika duhet të njihen nga autoritetet kompetente të dy vendeve;

b) të kenë një kosto të barabartë ose më të lartë se 1,2 miliard (lireta ose barasvlera në Lekë);

c) të lejojnë një pjesëmarrje minoritare prej 20% (njëzet për qind), që mund të kufizohet brenda mundësive financiare, në përputhje me kontratën e bashkëprodhimit; në rast se preventivi i koston së filmit është më i lartë se 2,4 miliard lireta italiane ose barasvlera në lek, kontributi minoritar mund të reduktohet në jo më pak se 10% (dhjetë për qind); në raste të jashtëzakonshme autoritetet kompetente mund të miratojnë përqindje pjesëmarrjeje financiare më të lartë se 20% (njëzet për qind);

d) të kenë kushte të përcaktuara për dhënien e kombësisë nga legjislacioni në fuqi i vendit mazhoritar. Në çdo rast pjesëmarrja e interpretuesve të Vendit mazhoritar mund të kufizohet deri në mazhorancën e interpretuesve dytësore.

e) të përfshijnë në kontratën e bashkëprodhimit dispozita që lidhen me shpërndarjen e të ardhurave.

Përfitimi nga bashkëprodhimi dypalësh do të jepet për çdo vepër që ka marrë më parë autorizimin përkatës, që lëshohet për çdo rast, nga autoritetet shqiptare dhe italiane.

Në çdo rast, në llogaritjen e përgjithshme të bashkëprodhimit financiar, duhet të ketë një numër të njëjtë filmash me pjesëmarrje mazhoritare shqiptare dhe filma me pjesëmarrje mazhoritare italiane; kontributet financiare të kryera nga njera palë dhe nga tjetra duhet të jenë të ekuilibruara; me qëllim ekuilibrit e sipërpërmendur, mund të merret parasysh paragrafi i dytë i nenit 9 të kësaj Marrëveshjeje.

Nëse gjatë dy viteve realizohet numri i filmave që i përgjigjen kushteve të lartpërmendura, Komisioni i përbashkët (neni 18) do të mbledhet për të shqyrtuar nëse është respektuar ekuilibri financiar dhe për të përcaktuar nëse vepra të tjera kinematografike mund të përfitojnë nga bashkëprodhimi.

Në pamundësi të mbledhjes së Komisionit të përbashkët, autoritetet kompetente mund t'u japin përfitime nga bashkëprodhimi financiar, me kusht reciprocitetin, dhe rast pas rasti, filmave që u përgjigjen të gjitha kushteve të sipërtreguara.

Neni 17

Importimi, shpërndarja dhe projektimi i filmave shqiptarë në Itali dhe atyre italianë në

Shqipëri, nuk do të varen nga asnjë kufizim, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara nga legjislacioni dhe rregulloret në fuqi në secilin nga dy Vendet.

Po kështu, Palët kontraktuese do të ripohojnë dëshirën e tyre për të favorizuar dhe zhvilluar me të gjitha mënyrat, shpërndarjen në secilin prej Vendeve të filmave të Vendet tjetër.

Neni 18

Autoritetet kompetente të të dy Vendeve do të shqyrtojnë, nëse është e nevojshme, kushtet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, me qëllim zgjidhjen e vështirësive që dalin në zbatimin e dispozitave të saj. Njëkohësisht, do të studiojnë ndryshimet e nevojshme për zhvillimin e bashkëpunimit kinematografik në interesin e përbashkët të të dy Vendeve.

Ato do të mbledhen, në kuadrin e një Komisioni të përbashkët, që do të mbahet parimisht një herë në dy vjet, në mënyrë alternative në secilin nga Vendet. Megjithatë mund të thirret një mbledhje e jashtëzakonshme me kërkesën e njerit prej dy Autoriteteve kompetente, në mënyrë të veçantë në rast ndryshimesh ligjore të rëndësishme apo të rregullores, përse i përket industrisë kinematografike apo dhe në rast se Marrëveshja has vështirësi të mëdha në zbatimin e saj.

Konkretisht, do të shqyrtojnë nëse është respektuar ekuilibri numerik dhe përqindja e prodhimeve të përbashkëta kinematografike.

Neni 19

Dispozitat që përmban kjo Marrëveshje nuk paragjykojnë detyrimet ndërkombëtare të Palëve Kontraktuese, përfshirë këtu, përse i përket Republikës Italiane, detyrimet që rrjedhin nga normativat e Bashkimit Europian.

Neni 20

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të dytë pasardhës nga data e marrjes së njoftimit të dytë, me anë të së cilit Palët kontraktuese do t'i kenë komunikuar zyrtarisht njëra-tjetrës realizimin e procedurave të brendshme përkatëse të parashikuara për ratifikimin.

Kohëzgjatja e kësaj Marrëveshjeje do të jetë dy vjet dhe do të rinovohet vetvetiu për periudhat pasardhëse me të njëjtën kohëzgjatje.

Secila nga Palët mund të denoncojë këtë Marrëveshje me anë të një njoftimi të shkruar Palës tjetër, në rrugë diplomatike, ku i paraqet qëllimin e saj për denoncim. Denoncimi do të ketë efekt pas tre muajsh nga data e njoftimit.

Zgjidhja e parakohshme e kësaj Marrëveshjeje nuk do të ketë efekt mbi përfundimin e bashkëprodhimeve që janë miratuar gjatë vlefshmërisë së saj.

Për sa më sipër, përfaqësuesit e mëposhtëm të autorizuar nga Qeveritë përkatëse, kanë firmosur këtë Marrëveshje.

Bërë në Tiranë, më 10.5.2002 në dy origjinalë, secili në gjuhët shqip dhe italisht, të dyja tekstet e barazvlefshëm.

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë

Për Qeverinë e Republikës Italiane

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
Z.Agron Tato

Ambasadori i Italisë
Z.Mario Bova

Aneks

Norma të procedurës

Kërkesa për miratimin e projekteve të bashkëprodhimit, sipas kësaj Marrëveshjeje, duhet t'i paraqitet njëkohësisht të dyja Palëve Kontraktuese, të paktën 40 ditë para fillimit të filmimeve. Vendi i bashkëprodhuesit mazhoritar do t'i komunikojë propozimin e tij vendit tjetër brenda 20 ditësh, duke nisur nga dita e marrjes së kësaj kërkesë. Në plotësim të kërkesave, për të përfituar nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, duhet të bashkangjiten:

- 1.skenari dhe subjekti;
 - 2.Prova e dokumentuar për fitimin ligjor të të drejtave të autorit për bashkëprodhimin që do të realiohet;
 - 3.Kopja e kontratës së bashkëprodhimit (*), e nënshkruar me rezervë aprovimi nga Autoritetet kompetente të të dy Vendeve.
(*)Kontrata duhet të përmbajë këto elementë:
 - a)Titulli i filmit;
 - b) Identifikimi i prodhuesve kontraktues;
 - c) Emri dhe mbiemri i autorit të skenarit ose të përshtatësit, nëse është nxjerrë nga ndonjë pjesë letrare;
 - d) Emri dhe mbiemri i regjisorit (lejohet një klauzokë zëvendësimi në rast nevojë);
 - e) Bilanci preventiv që paraqet përqindjen e pjesëmarrjes së secilit prodhues, i cili duhet t'i korrespondojë vlerës financiare të kontributeve tekniko-artistike.
 - f) Plani financiar;
 - g) Klauzola që përcakton ndarjen e çfarëdo lloj fitimi dhe territori;
 - h) Klauzola që specifikon pjesëmarrjet përkatëse të bashkëprodhuesve në shpenzimet e mëdha apo të vogla. Pjesëmarrje të tilla, në vija të përgjithshme, do të jenë në përpjestim me kontributet përkatëse. Pjesëmarrja e bashkëprodhuesit minoritar në rast tejkalimi shpenzimesh mund të kufizohet në një përqindje më të vogël apo në një sasi fikse duke respektuar gjithmonë kontributin minimal prej 20% ose prej 10%, në rast bashkëprodhimi financiar për filmat me vlerë më të lartë se 2,4 miliard lireta italiane ose barasvlera në lekë;
 - i) Klauzola mbi masat që duhen marrë nëse pas një shqyrtimi të plotë të rastit, Autoritetet kompetente të njerit prej Vendeve nuk pranojnë të japin përfitimet e kërkuara, dhe në rast se secila nga Palët nuk përmbush detyrimet e veta;
 - j) Data e fillimit të filmimeve;
 - k) Klauzola që parashikon rindarjen e pronsisë së të drejtave të autorit, mbi një bazë proporcionale në lidhje me kontributet përkatëse të bashkëprodhuesve;
 - l) Klauzola që parashikon se njohja e përfitimeve nga kjo marrëveshje nuk i detyron Autoritetet kompetente italiane të japin miratimin për projektimin në publik.
 - 4) Kontratë shpërndarjeje, pas nënshkrimit.
 - 5) Lista e personelit krijues, artistik e teknik që tregon kombësinë dhe kategorinë e punës së tyre; në rastin e aktorëve, kombësinë dhe rolet që do të luajnë, duke treguar kategorinë dhe kohëzgjatjen e tyre.
 - 6) Programimi i kategorisë duke treguar shprehimisht kohëzgjatjen e përafërt të filmimeve, vendet ku do të zhvillohen këto të fundit dhe planin e punës.
 - 7) Bilanci i detajuar i preventivit, që identifikon shpenzimet e parashikuara për secilin prej bashkëprodhuesve.
- Autoritetet kompetente të të dy Vendeve mund të kërkojnë dokumente të tjera ose informacione shtesë që ato konsiderojnë të nevojshme.
- Nëse është e nevojshme mund t'i bëhen ndryshime kontratës origjinale, por këto ndryshime duhet t'i paraqiten për aprovim Autoriteteve kompetente të të dy Vendeve para përfundimit të nxjerrjes së kopjes kampion të filmit. Zëvendësimi i një bashkëprodhuesi do të pranohet të bëhet vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe me pëlqimin e Autoriteteve kompetente të të dy Vendeve.
- Autoritetet kompetente do të njoftojnë njera tjetrën për vendimin përkatës.